



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI PËR NDIHMËN SHTETËRORE

DRAFT LAW ON STATE AID

NACRT ZAKONA O DRŽAVNOJ POMOĆI



REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI	REPUBLIC OF KOSOVO ASSEMBLY	REPUBLIKA KOSOVA SKUPŠTINA
<p>Në mbështetje të nenit 65 paragrafi (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p>	<p>Pursuant to Article 65, paragraph (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo hereby,</p>	<p>Na osnovu člana 65 stav (1) Ustava Republike Kosovo,</p>
<p>Miraton:</p>	<p>Adopts:</p>	<p>Usvaja:</p>
<p>LIGJIN PËR NDIHMËN SHTETËRORE</p>	<p>DRAFT LAW ON STATE AID</p>	<p>ZAKON O DRŽAVNOJ POMOĆI</p>
<p>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p>	<p>GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p>	<p>OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Cilj</p>
<p>Me këtë ligj përcaktohen parimet dhe procedurat, në përputhje me të cilat lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore, me qëllim që të mbështetet zhvillimi ekonomik dhe social, të zbatohen parimet e funksionimit të ekonomisë së tregut, të mbrohet konkurrenca, si dhe të përmbushen detyrimet e dala nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, ku përfshihen dispozitat për ndihmën shtetërore.</p>	<p>The present Law sets-out principles and procedures, in accordance with which the state aid is allowed and controlled, in order to support the economic and social development, apply the principles of functioning of the market economy, protect competition, as well as implementation of commitments arising from international agreements ratified by the Republic of Kosovo, where the provisions for state aid are included.</p>	<p>Ovim zakonom se utvrđuju načela i procedure, u saglasnosti sa kojima se dozvoljava i kontroliše se državna pomoć u cilju podrške privrednog i socijalnog razvoja, primene načela funkcioniranja tržišne privrede, zaštite konkurencije i ispunjavanja obaveza koja proizilaze iz međunarodnih sporazuma, ratifikovanih od Republike Kosova, u skladu s kojima su i odredbe o državnoj pomoći.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Ky ligj zbatohet për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve që veprojnë në Republikën e Kosovës, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë dhe të peshkimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope of the Law</p> <p>The present Law applies to all sectors of production as well as services operating in the Republic of Kosovo, in exception of the sector of agriculture and fishery.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Ovaj zakon će se primeniti u svim sektorima proizvodnje i usluga u Republici Kosova, izuzev sektora poljoprivrede i ribarskog gazdinstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Termat e mëposhtëm, në këtë ligj, kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Ndihma shtetërore- është çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore në cilëndo formë, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, cenon apo rrezikon konkurrencën duke dhënë përparësi për një apo disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara. Ndihma shtetërore mund të përfshij por nuk kufizohet në: grantet dhe subvencionet; lirimin, uljen dhe diferencimin e taksave; faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave; faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve; garancitë mbi kreditë ose dhënieve të kredive me norma interesi të ulta; uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore; uljen e çmimit të mallrave dhe shërbimeve të</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. According to the present Law, the following definitions have these meanings:</p> <p>1.1. State Aid- is any aid granted by the state or through state resources, in any form whatsoever which directly or indirectly distorts or threatens to distort competition by favouring certain undertakings or the production of certain goods. State aid may include but it is not limited to: grants and subsidies; tax exemption, reduction and differentiation; remission of overdue payments and fines; remission of debt or covering losses; guarantees on loans or granting loans under low interest rates; reduction of social insurance commitments; reducing the price of goods and services provided, or the sale of state property below the market price, or purchase of goods and services with the price higher than the one</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Dole navedeni izrazi imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. Državna pomoć- je svaka pomoć izdata od državnih izvora u bilo kojoj formi koja na direktan ili indirektan način, narušavali rezikuje konkurenciju davanjem prioriteta za jednu ili nekoliko određena preduzeca ili proizvodnju određenih proizvoda. Državna pomoć može da obuhvati ali ne ograničuje se: grantove i subvencije; oslobađanje, smanjenje i diferenciranje dadžbina; oslobađanje od zakasnelih uplata i kazni; brisanje dugova ili pokrivanje gubitaka; kreditne garancije ili izdavanje kredita sa niskim kamatnim stopama; smanjenje obaveza društvenih osiguranja; smanjenje cena roba i usluga ili prodaju državne imovine ispod tržišne cene, kupovinu roba i usluga cenom, većem od</p>



<p>ofruara, ose shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut, ose blerjen e mallrave dhe shërbimeve me çmim më të lartë se ai i tregut; zmadhimin e kapitalit shtetëror tek ndërmarrjet ose ndryshim të vlerës së tij, në rrethana që nuk janë të pranueshme për një investitor privat që vepron në kushte ekonomike normale.</p> <p>1.2. Dhënësit e ndihmës shtetërore- janë të gjitha organet e administratës qendrore dhe të qeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, apo autoritetet që veprojnë në emër të shtetit dhe japin përfitim për ndërmarrje apo sektorë të veçantë.</p> <p>1.3. Ndërmarrje- është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike.</p> <p>1.4. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme- janë ndërmarrjet e klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.</p> <p>1.5. Skema e ndihmës- është akti normativ mbi bazën e të cilit, në formë të përgjithshme dhe pa patur nevojë për akte tjera zbatuese mund të planifikohet apo jepet ndihma shtetërore.</p>	<p>in the market, increasing state capital in the undertakings or changing its value, in circumstances that are not acceptable for a private investor operating in normal economic conditions.</p> <p>1.2. Providers of state aid- means all central public administration authorities and local self-government units, public undertakings, or entities, operating on behalf of the state in terms of granting state aid for undertakings or special sectors.</p> <p>1.3. Undertaking- means any natural or legal person, private or public, which performs economic activity.</p> <p>1.4. Small and medium undertakings- are undertakings classified according to the applicable legislation for small and medium undertakings.</p> <p>1.5. Aid scheme- is any normative act upon which in general form and without the need for other implementing acts, the state aid can be planned or granted.</p>	<p>tržišne; povećanje državnog kapitala kod preduzeća ili izmenu njegove vrednosti u okolnostima koji su neprihvatljivi za privatne investitore koji rade u normalnim privrednim uslovima.</p> <p>1.2. Davaoci državne pomoći- su svi organi centralne i lokalne administracije, javne proizvođača, ili ustanove koje rade u ime države i daju dobitak za određeno preduzeće ili posebni sektor.</p> <p>1.3. Preduzeće- je fizičko ili pravno lice, ili privatno, odnosno javno lice, koje vrše privrednu delatnost;</p> <p>1.4. Mala i srednja preuzeća- su preduzeća podeljena prema važećim zakonskim propisima u manjim i srednjim preduzećima.</p> <p>1.5. Šema pomoći- je svaki normativni akt na osnovu kojeg, bez potrebe za drugim aktama, može se uopšte planirati i izdavati državna pomoć.</p>
--	--	--



<p>1.6. Ndihma individuale- është çdo ndihmë që i jepet një përfituesi të veçantë për një rast, ose kur vlera e ndihmës që i jepet një përfituesi të vetëm, në kuadër të një skeme të ndihmës, është më e lartë se kufiri minimal i lejuar.</p> <p>1.8. Ndihmë e paligjshme- është çdo ndihmë shtetërore që jepet dhe zbatohet në kundërshtim me këtë ligj ose në kundërshtim me vendimet e marra nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.</p> <p>1.9. Palët e interesuara- janë palët që ju është ndarë ndihma, si dhe ndërmarrjet ose shoqatat konkurrenente, interesat e të cilave mund të preken nga dhënia e ndihmes.</p> <p>1.10. Ndihma për riskun e kapitalit- është financimi, që u bëhet ndërmarrjeve, dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital në formën e kuotave, të aksioneve ose obligacioneve të konvertueshme në aksione, në fazat e para të rritjes themelimit dhe administrimit të tyre.</p> <p>1.11. Njoftimi- është kërkesa që paraqitet nga dhënësi i ndihmës, për miratimin e planit të ndihmës shtetërore, e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.</p>	<p>1.6. Individual Aid- shall mean any state aid granted to a specific beneficiary for a single case, or when the value of the aid granted to a single beneficiary, within an aid scheme, is higher than the minimum allowed ceiling.</p> <p>1.8. Unlawful Aid- is any state aid granted and implemented in contradiction with the present Law or in contradiction with the decisions taken by the State Aid Office.</p> <p>1.9. Stakeholders- shall mean the aid beneficiaries as well as undertakings or competing associations, whose interests may be affected by the granting of aid.</p> <p>1.10. State aid to Promote Capital Risk- is the financing of undertakings and small and medium undertakings, through participation in capital in the form of quotas, shares or bonds convertible to shares, in the early stages of their growth/establishment and management.</p> <p>1.11. Notification- is the requirement presented by the aid provider, for approval of state aid plan, accompanied with all the documents specified in the present Law and its implementing acts.</p>	<p>1.6. Individualna pomoć- je pomoć koja se daje određenom korisniku za određeni slučaj ili kada je iznos pomoći koja se daje određenom korisniku, u okviru šeme pomoći i veća od minimalnog dozvoljenog limita.</p> <p>1.8. Nezakonita pomoć- je svaka državna pomoć koja se daje i provodi u suprotnosti sa ovim Zakonom ili odluka Komisije za državnu pomoć.</p> <p>1.9. Zainteresovane strane- su stranke kojima je dodeljena pomoć, kao i preduzeća i konkurentna udruženja, čije se interese zadiru davanjem pomoći.</p> <p>1.10. Pomoć za rizik kapitala- je finansiranje koja je napravljena preduzećima ili mala i srednja preduzeća kroz učešće u kapitalu u obliku kvota, deonica ili obligacija koje se mogu pretvoriti u deonice, u prvim fazama rasta njihovog osnivanja i upravljanja.</p> <p>1.11. Informisanje- je zahtev koji dostavlja ili podnosi davaoc pomoći za odobravanje plana državne pomoći, proračun svom dokumentacijom, koju predviđa ovaj Zakon i druga akta o njegovoj primeni.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 4 Ndalimi i ndihmës shtetërore</p> <p>Përveç rasteve të parashikuara ndryshe me këtë ligj, ndihma shtetërore ashtu siq është e definuar në nenin 3 të këtij ligji ndalohet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Ndihma e lejueshme</p> <p>1. Është e lejueshme:</p> <p>1.1.Ndihma e karakterit social, që u ndahet konsumatorëve individual, nëse nuk bën diskriminime që lidhen me origjinën e prodhimeve,</p> <p>1.2.Ndihma në rastet e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ose për raste të veçanta që lidhen me sigurinë kombëtare.</p> <p>1.3. Ndihma “de minimis”, nëse shuma e saj nuk kalon vlerën prej 30.000 euro, brenda cilësdo periudhe tri vjeçare, pavarësisht nga forma e ndihmës ose qëllimi për të cilin jipet e, në të njëjtën kohë, që nuk jipet për veprimtaritë e eksportit, nuk kushtëzohet me përdorimin e prodhimeve vendase kundrejt atyre të importuara dhe përfituesi nuk është një ndërmarrje në vështirësi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 State Aid Prohibition</p> <p>Save as otherwise provided in this law, State aid as defined by Article 3 shall be prohibited.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Allowed Aid</p> <p>1. The following aids are allowed:</p> <p>1.1.Aid of social character, granted to individual customers, if not discriminatory regarding the origin of products;</p> <p>1.2.Aid in case of damages caused by natural disasters, or for special cases related to national security;</p> <p>1.3.“De Minimis” Aid, if its amount given to an undertaking does not exceed €30,000, over any three year period, irrespective of the form of the aid or the purpose for which is was granted and, simultaneously, is not granted for export-related activities, is not conditions with the use of domestic products vis-à-vis those imported and the beneficiary is not an undertaking in difficulty.</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Zabrana državne pomoći</p> <p>Izuzev slučajeva koji su ovim zakonom drugačije predviđeni, državna pomoc onako kako je određeno u član 3 ovog zakona zabranjuje se.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Dozvoljena pomoć</p> <p>1. Dozvoljena je pomoć:</p> <p>1.1.socijalnog karaktera koja se dodeljuje individialnim potrošačima i ako ne diskriminira poreklo proizvoda.</p> <p>1.2.u slučaju štete uzrokovane od elementarnih nepogoda ili za posebne slučajeve vezane za nacionalnu sigurnost.</p> <p>1.3.Pomoć „de minimis“ ako njen iznos ne prelazi 30.000€ u bilo kom trogodišnjem periodu, nezavisno od oblika pomoći ili namene za koju je dodeljena, i koja se ne daje za izvozu delatnost, ne uslovljava se korišćenjem domaćih porizvoda u odnosu na uvozne, a korisnik nije preduzeće koja se nalazi u teškoćama.</p>
--	---	--



Neni 6 Ndihma shtetërore që mund të lejohet	Article 6 Aid which may be compatible	Član 6 Državna pomoć koja se može dozvoliti
<p>1. Mund të lejohet ndihma:</p> <p>1.1. Që jepet për të promovuar zhvillim ekonomik në rajonet e Republikës së Kosovës ku standardi i jetesës është jashtëzakonisht i ulët apo ku papunësia është shumë e lartë.</p> <p>1.2. Që jepet për të mënjanuar çrregullime serioze në ekonominë e Republikës së Kosovës apo nxitë realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Kosovës,</p> <p>1.3. Që lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike deri masën e cila nuk ndikon negativisht në kushtet tregtare, dhe nuk është në kundërshtim me interesin e përbashkët sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës;</p> <p>1.4. Që nxit kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë;</p> <p>1.5. Ndihma tjetër që është në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p>	<p>1. The following aids may be compatible:</p> <p>1.1 To promote the economic development of areas of the Republic of Kosovo where the standard of living is abnormally low or where there is serious unemployment;</p> <p>1.2 to remedy a serious disturbance in the economy of the Republic of Kosovo or to promote the execution of an important project of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3.that facilitates the development of certain economic activities or of certain economic areas, to a degree which this aid does not adversely affect trading conditions to an extent contrary to the common interest under the international agreements ratified by the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4.promotes the culture and heritage conservation, to a degree which this aid does not affect seriously the trade conditions and competition;</p> <p>1.5. That is in accordance with the provisions of the present Law.</p>	<p>1. Može se dozvoliti pomoć:</p> <p>1.1. koja se izdaje da promovise ekonomski razvoj u oblastima na Republici Kosova gde životni standardi su izuzetno niski ili kojima je stopa nezaposlenosti je veoma visoka.</p> <p>1.2. Koja se izdaje za otklanjanje ozbilne poremećaje u privredu Republike Kosova ili podstiče realizaciju važnog projekta za Republiku Kosova,</p> <p>1.3. koja olakšava razvoj određenih privrednih delatnosti ili razvoj određenih privrednih oblasti do te mere koja ne utice negativno uticati na uslove trgovine i nije u suprotnosti sa zajednickih interesa u okviru međunarodnih sporazuma ratifikovanih od Republike Kosova;</p> <p>1.4. koja potsitiče kulturu i čuvanje baštine do te mere koja neće znatno uticati na konkurenciju i tržišne uslove;</p> <p>1.5. Druga Pomoć koja je u skladu sa odredbama ovog Zakona.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 7 Zyra e ndihmës shtetërore</p> <p>1. Zyra e ndihmës shtetërore, tani e tutje Zyra, është njësi administrative për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe krijohet në kuadër të Komisionit Kosovar të Konkurrencës.</p> <p>2. Zyra është përgjegjëse për marrjen, analizën dhe mbikëqyrjen e njoftimeve dhe të dhënave të tjera në lidhje me skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale. Ajo përgatit raportet vlerësuese të ndihmave shtetërore dhe vendimet e Komisionit.</p> <p>3. Funkcionet dhe struktura e Zyrës do të caktohen me akt nënligjor, të cilin e nxjerr Komisioni Kosovar i Konkurrencës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 State Aid Office</p> <p>1. State Aid Office (hereinafter the Office), is the administrative unit for controlling the state aid and is established within the Kosovo Competition Commission.</p> <p>2. The Office is responsible for receiving, analyzing and monitoring of notifications and other data on aid schemes and individual aid. Office is responsible for preparing assessment reports of state aid as well as decisions of the Commission.</p> <p>3. Functions and the structure of the Office shall be set-out with a bylaw, issued by the Kosovo Competition Commission.</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Kancelarija za državnu pomoć</p> <p>1. Kancelarija za državnu pomoć (u daljem tekstu: „Kancelarija“) je administrativna jedinica za kontrolu državne pomoći i formira se u okviru Komisija Kosova za Konkurenciju.</p> <p>2. Kancelarija i odgovorna za prijem, analizu i nadzor informacija i drugih podataka vezanih za šemu pomoći i za individualnu pomoć. Ona priprema izveštaje o ocenjivanju državne pomoći i odluke za Komisiju.</p> <p>3. Funkcije i struktura Kancelarije regulišu se podzakonskim aktom koji donosi Komisija Kosova za Konkurenciju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Komisioni i Ndhmës Shtetërore</p> <p>1. Organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore është Komisioni i Ndhmës Shtetërore, (tani e tutje Komisioni). Komisioni vepron mbi baza “Ad hoc” dhe është i pavarur në vendimmarje dhe ushtrimin e funksioneve të tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 State Aid Commission</p> <p>1. The decision-making body for state aid control is the State Aid Commission, thereafter the Commission. The Commission acts on “Ad Hoc” basis and is independent in exercising its powers and has decisional independence.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Komisija za državnu pomoć</p> <p>1. Organ koji odlučuju za kontrolu državne pomoći je Komisija za državnu pomoć (u daljem tekstu: „Komisija“). Komisija radi „ad hoc“ i samostalna je u obavljanju svojih funkcija.</p>



<p>2. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë ne përbërje të:</p> <p>2.1. Ministri i Financave, Kryesues. 2.2. Ministri për Integrime Evropiane. 2.3. Ministri i Tregtise dhe Industrise. 2.4. Shoqëria Civile-një anëtar dhe 2.5. Kryetari i asociacionit të Komunave.</p> <p>3. Komisioni emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në propozimin e Ministrise së Financave.</p> <p>4. Anëtarët e Komisionit emërohen për një periudhë prej 4 vjetësh me vendim të Qeverisë së Kosovës.</p> <p>5. Komisioni i ndihmës shtetërore, i përkrahur nga Zyra, gjithashtu do të kryej funksionet e percaktuara me ligjet tjera.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Ruajtja e sekretit</p> <p>Informatat dhe të dhënat e karakterit sekret që nxirren gjatë procedurave për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore, punonjësit e Zyrës dhe anëtarët e Komisionit, janë të detyruar t'i mbajnë sekret edhe pas përfundimit të funksioneve të tyre apo pas përfundimit të marrëdhënieve të tyre të punës.</p>	<p>2. The Commission consists of five members. comprising of:</p> <p>2.1. The Minister of Finance, Chairman; 2.2. The Minister of European Integration; 2.3. The Minister of Trade and Industry; 2.4. Civil Society- a member; and 2.5. Chairman of Association of Kosovo Municipalities.</p> <p>3. The Commission is appointed by the Government of Republic of Kosovo based on the proposal of the Ministry of Finance.</p> <p>4. Commission members are appointed for a period of 4 years with the decision of the Government of Kosovo.</p> <p>5. The State aid Commission, supported by the Office, shall also carry out the functions assigned to it by other legislation.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Maintaining the Confidentiality</p> <p>The Office staff and members of the Commission are obliged to keep in secrecy all the confidential information and data issued during the state aid assessment and supervision procedures, even after performing their functions or after completion of their employment period.</p>	<p>2. Komisija se sastoji od 5 članova, i to od:</p> <p>2.1. Ministra privrede; 2.2. Ministra Evropskih integracije; 2.3. Ministra trgovine i industrije; 2.4. Civilno društvo- jedan član; i 2.5. Predsednika Udruzenja opstina Kosova.</p> <p>3. Komisiju imenuje Vlada Republike Kosova na osnovu predloga Ministarstva za finansije.</p> <p>4. Članovi Komisije se imenuju za jedan vremenski period od 4 godina odlukom Vlade Kosova.</p> <p>5. Komisija Državne pomoći uz podršku Kancelarije takođe će obavljati određene funkcije i sa drugim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Čuvanje tajne</p> <p>Informacije i podaci koji su povrljivog karaktera a dobiju se u toku procedura ocenjivanja i nadzora državne pomoći članovi Kancelarije i članovi Komisije su dužni da čuvaju u tajnosti i nakon okončanja njihovog mandata ili okončanja radnog odnosa.</p>
---	---	---



Neni 10 Njoftimi	Article 10 Notification	Član 10 Informisanje
<p>1. Për të gjitha planet e ndihmës shtetërore, dhënësi i ndihmës duhet t'i paraqesë Zyrës njoftimin e plotë. Nëse brenda 15 ditëve të punës nga marrja e njoftimit për ndihmën shtetërore të propozuar (apo informata shitesë, Zyra nuk kërkon nga dhënësi i ndihmës shtetërore informacion shitesë të mëtejshëm, do të konsiderohet se Zyra ka të gjitha informatat e duhura për vlerësimin e ndihmës shtetërore të njoftuar.</p> <p>2. Njoftimi duhet të përmbajë:</p> <p>2.1. të dhënat e plota për planin e ri të ndihmës shtetërore apo modifikimin e ndihmës shtetërore, të miratuar më parë nga Komisioni.</p> <p>2.2. të dhënat për ndihmën shtetërore ekzistuese, e cila ka filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe vazhdon të ofrohet edhe pas hyrjes në fuqi të tij.</p> <p>2.3. Format i njoftimit është i përcaktuar në aneksin I të aktit nënligjor “Për procedurat dhe formatin e njoftimit”, i cili nxirret nga Ministria e Financave</p> <p>3. Njoftimi nuk është i domosdoshëm në</p>	<p>1. The state aid provider shall submit to the Office a complete notification on all state aid plans. If within 15 working days from the receipt of a notification on a proposed state aid or additional information, the Office does not request further additional information from the aid provider, it shall be deemed that the Office possesses sufficient information for assessment of the notified State aid.</p> <p>2. The Notification must contain:</p> <p>2.1. full data on the new state aid plan or modification of existing aid, approved previously by the Commission;</p> <p>2.2. existing state aid, started prior to entry into force of the present Law and which continues to be provided;</p> <p>2.3. The Notification form is set forth in the Annex I of the bylaw “On Notification Procedures and Form”, issued by the Ministry of Finance.</p> <p>3. A notification is not necessary in cases</p>	<p>1. O svim planima državne pomoći davaoc pomoći treba da Kancelariji dostavlja kompletnu informaciju. Ako u roku od 15 radnih dana od dana prijema obaveštenja za predloženu državnu pomoć ili dodatne informacije. Ako Kancelarija ne zahteva od davaoca državne pomoći dalje dodatne informacije, smatra se da ona ima sve potrebne informacije za ocenjivanje državne pomoći o kojoj je obaveštena.</p> <p>2. Obaveštenje treba da sadrži:</p> <p>2.1. Kompletne podatke o novom planu državne pomoći ili modifikaciji državne pomoći usvojenoj prethodno od Komisije.</p> <p>2.2. Podatke o postojećoj državnoj pomoći koja je počela pre stupanja ovog zakna na snazi i nastavlja se nakon njegovog stupanja na snazi.</p> <p>2.3. Format informacije je određen u Aneksu I podzakonskog akta „o procedurama i formatu informisanja“, koji donosi Ministarstvo za finansiju.</p> <p>3. informisanje nije neophodno u slučaju da</p>



<p>rastin kur ndihma individuale është dhënë sipas skemës të cilën Komisioni e ka miratuar me vendim sipas nenit 11 paragrafit 3 të këtij ligji, përveç rasteve kur vlera e ndihmës individuale duhet të njoftohet në përputhshmëri me rregullat e veçanta të vendimit të Komisionit, sa i përket ndihmës shtetërore për industrinë e veçanta.</p> <p>4. Aty ku njoftimi për ndihmë shtetërore nuk është kompletuar, Zyra, brenda një periudhe prej 15 ditësh nga pranimi i njoftimit, duhet të kërkojë të gjitha informatat shtesë.</p> <p>4.1.Dhënësi i ndihmës shtetërore, në afat prej 15 ditëve të punës nga marrja e kërkesës së Zyrës, duhet t'i dorëzojë asaj të gjitha informatat shtesë të kërkuara.</p> <p>4.2.Në rastin kur dhënësi i ndihmës shtetërore nuk i paraqet informatat e kërkuara apo informatat e paraqitura nuk janë të plota, Zyra, brenda afatit prej 15 ditëve të punës, do të përsërisë kërkesën, duke lejuar një periudhë shtesë të përshtatshme deri në 15 ditë pune, gjatë të cilave informatat e kërkuara do të paraqiten pranë Zyrës.</p> <p>4.3.Njoftimi quhet i tërhequr,</p>	<p>where the individual assistance is provided under the scheme approved by the Commission with a decision according to the Article 11 Paragraph 3 of the present Law, except cases when amount of the individual aid must be notified in accordance with specific rules of Commission decision, in terms of state aid to specific industries.</p> <p>4. Where the notification on state aid is not complete, the Office's shall, within a period of 15 business days from the receipt of the notification, request all necessary additional information.</p> <p>4.1.the state aid provider shall submit this information within 15 working days from the receipt of the request of the Office;</p> <p>4.2.In cases when the state aid provider fails to submit the requested information or the information presented is not complete, the Office, not later than 15 working days, shall repeat the request allowing an appropriate additional period no longer than 15 working days within which the information shall be provided and submitted to the Office.</p> <p>4.3.The Notification must be withdrawn</p>	<p>je individualna pomoć data prema šemi koju je Komisija usvojila odlukom na osnovu člana 11 stav 3 ovog Zakona, izuzev slučaja kada iznos individualne pomoći treba da se izvesti u skladu sa posebnim pravilima odluke Komisije, državna pomoć za posebne industrije.</p> <p>4. Tamo gde informacija o državnoj pomoći nije kompletirana, Kancelarija će u roku od 15 dana od dana prijema informacije zatražiti sve dodatne podatke.</p> <p>4.1.davaoc državne pomoći će u roku od 15 radnih dana od dana prijema zahteva od Kancelarije, dostaviti sve zahtevane dodatne informacije.</p> <p>4.2.u slučaju da davaoc državne pomoći ne dostavlja zahtevane informacije ili dostavljene informacije nisu potpune, Kancelarija će u roku od 15 radnih dana, obnoviti zahtev dajući jedan dodatni pogodni rok 15 radnih dana, u kojem će se dostavljati Kancelariji zatražene informacije.</p> <p>4.3.obaveštenje se smatra povlačenom,</p>
---	---	---



